



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS Kryesuesi i Kuvendit

RAPORT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

Kuvendi i Komunës së Podujevës duke u bazuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022, procedimit dhe çështjeve të ndryshme nga Ekzekutivi i Komunës dhe varësisht nevojave të paraqitura si dhe në bazë nenit 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, paraqitet Raporti në vijim:

Kuvendi i Komunës së Podujevës gjatë kësaj periudhe ka funksionuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, ligjeve tjera të veçanta varësisht fushave përkatëse, akteve të tjera nënligjore, Statutit të Komunës së Podujevës si dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Gjatë vitit 2022, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka mbajtur 15 mbledhje prej tyre 7 të rregullta, 4 mbledhje të jashtëzakonshme (1 e ndërprerë), 4 mbledhje solemne, ndërsa që nga fillimi i këtij mandati e deri më tani janë mbajtur 18 mbledhje të Kuvendit duke përfshirë edhe mbledhjen konstituive/inauguruese, në përputhje të plotë me nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në të cilin ndër të tjera thuhet:

Neni 43

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

43.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

43.2 Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

43.3 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

a) data e mbajtjes së mbledhjes;

b) koha e mbajtjes së mbledhjes;

c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;

d) rendi i ditës për mbledhje; dhe

e) materialet e mbledhjes.

f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

43.4 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.

43.5 Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë Planin e Punës për vitin 2022 ka shqyrtuar çështje/pikat e parapara por edhe çështje të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës si dhe çështje të përcaktuara nga Grupe të këshilltarëve të Kuvendit dhe anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Në vijim paraqiten temat – çështjet e shqyrtuara në Kuvend, sipas mbledhjeve gjatë vitit 2022, (renditja sipas datave të mbledhjeve të Kuvendit në vitin 2022)

Mbledhja e mbajtur më 14.01.2022 – e jashtëzakonshme

1. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024
2. Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022

Mbledhja e mbajtur më 17.02.2022 – solemne

Intonimi i Himneve

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit
 - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

Mbledhja e mbajtur më 28.02.2022 – e rregullt

Dhënia e betimit të anëtarëve të zëvendësuar / emëruar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve - KQZ (Ardi Hasani, Haki Rudari, Ragip Fetahu, Bahri Blakçori, Xhevdet Maloku)

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 29.12.2021; 14.01.2022
2. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022.
3. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinae "Pastrimi" sh.a.
4. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë.
5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - për Banim sh.a. Podujevë.
6. Propozim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.
7. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve
 - Propozim vendimi për vënien në diskutim publik.
8. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative - arsimore të Komunës së Podujevës
 - Propozim vendimi për vënien në diskutim publik.
9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në Qytetin Podujevës.
10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë.
11. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor të shkollave.
12. Propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike
13. Propozim vendimi për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit Komunave të Republikës së Kosovës.
14. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimi nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018.
15. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinae - KRM "Pastrimi" Sh.A.
16. Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022.

Mbledhja e mbajtur më 05.03.2022 - solemne

Për nderë të Shënimit të "EPOPEËSË së UÇK-së" dhe ka për qëllim shënimin dhe promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës

- Intonimi i Himnit

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit
 - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës
3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së

Mbledhja e mbajtur më 16.03.2022 – e jashtëzakonshme (me kërkesë të 17 anëtarëve të Kuvendit)

- Ndarja e mjeteve buxhetore për pako ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë

-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare-ndihmë qytetarëve në nevojë, me pako ushqimore dhe higjienike.

-Vendim për ngritjen e komisionit ad-hoc-për mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes të pakove ushqimore dhe higjienike ndihmë familjeve në nevojë.

Mbledhja e mbajtur më 29.04.2022 - e rregullt

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:
17 shkurt 2022; 28 shkurt 2022; 05 mars 2022 dhe 16 mars 2022
2. Propozim Vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022 – 2030
3. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2021 në vitin 2022 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
4. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve
 - Raporti nga diskutimi publik
5. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës
 - Raporti nga diskutimi publik
6. Propozimi për nisjen/inicimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës
7. Propozim Vendimi për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB
8. Propozim Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive "Hakif Zejnullahu"
 - Propozim vendimi për vënie në diskutim publik
9. Propozim Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale
 - Propozim vendimi për vënie në diskutim publik
10. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
11. Raporti financiar për periudhën janar – mars 2022
12. Propozim Vendimi për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të dispozitave Rregullore nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, dhe atë: *neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2*
13. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
14. Rishqyrtimi i Vendimit nr.01-020/04-0014613/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, *të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2022*
15. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, të miratuar nga Kuvendi i Komunës më 28 shkurt 2022.
16. Rishqyrtimi i vendimit nr.prot.01-354/02-0014599/22 datës 28.02.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.01-354/02-0087371/18 datë 02.11.2018, i vlerësuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës-Shkresa nr. DL 1546-2/22 datë 25.03.2022.

Mbledhja e mbajtur më 20.05.2022 - e jashtëzakonshme (me kërkesë të 13 anëtarëve të Kuvendit)

- Gjendja e rëndë e krijuar në Arsim

Mbledhja e mbajtur më 19.06.2022 - Solemne

Për nder të Shënimit të 19 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Podujevës.

- Intonimi i Himnit

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit
 - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës
 - Fjalë rasti e përfaqësuesit të Qytetit Velbert të Gjermanisë
3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dalë nga Lufta e UÇK-së

Mbledhja e mbajtur më 30.06.2022, e vazhduar më 15/07.2022

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025 e Komunës së Podujevës.
2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe Publike në hapësirën e SHFMU "Xheladin Rekalii" në Podujevë.
3. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik:
 - Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës;
 - Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës: "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm.
4. Formimi i Komisionit për hartimin e draft Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.
5. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpikë në Podujevë (pikë shtesë e rekomanduar nga KPF)
6. Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLE "Isa Boletini" nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMPLP në Institucione të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional-IAAP, (pikë shtesë e rekomanduar nga KPF)
7. Vendim për shpalljen e z.Halil Kastrati "Qytetar Nderi" i Komunës së Podujevës. (pikë shtesë e përfshirë në mbledhjen e Kuvendit)
8. Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Zhvillim Ekonomik, Komitetit për Barazi Gjinore, si dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. (pikë shtesë e përfshirë në mbledhjen e Kuvendit)
9. Draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës. (pikë shtesë e përfshirë në mbledhjen e Kuvendit)

Mbledhja e mbajtur më 29.07.2022 - e rregullt

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit, të mbajtura më; 29.04.2022, 30.05.2022 dhe 19.06.2022
2. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për 2021
 - Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit
3. Raporti Financiar janar - qershor 2022
4. Propozim vendimi për caktimin e normave të tatimit në pronë për vitin 2023
5. Propozim Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës
6. Propozimet për zëvendësimin e 2 anëtarëve të Komitetit për Komunitete (pas dhënies së dorëheqjes nga dy ish anëtar/e të Komitetit nga radhët e Komuniteteve jo shumicë)
7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022

8. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri-projekti "Furnizim dhe montim i serrave"
(*pikë shtesë e rekomanduar nga KPF*)
9. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri – projekti "Furnizim me mekanizëm bujqësor".
(*pikë shtesë e rekomanduar nga KPF*)
10. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri – projekti "Furnizim me mëshqerra".
(*pikë shtesë e rekomanduar nga KPF*)
11. Diskutim lidhur me furnizimin me ujë të pijes. (*pikë shtesë e rekomanduar nga KPF*)

Mbledhja e mbajtur më 12.09.2022 - solemne

Me rastin e ndarjes së titullit QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës për z.Halil Kastratin themelues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës.

Mbledhja e mbajtur më 14.09.2022 - e jashtëzakonshme (me kërkesë të 13 anëtarëve të kuvendit)

- Ndërtimet pa leje dhe formimi i një komisioni për këtë çështje
E ndërprerë në mungesë të kuorumit.....

Mbledhja e mbajtur më 29.09.2022 - rregullt

1. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për 2024/2025
2. Propozim Vendimi për ri-alokimin e investimeve kapitale të Komunës për vitin 2022
3. Propozim Rregullorja për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës
- Raporti nga diskutimet publike
4. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik-Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025
5. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik-Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban
6. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik-Draft Rregullorja për Bonuset e Zonimit
7. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi
8. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës
9. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik - Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit
10. Informatë për aktivitetet e KKSBB për vitin 2021
11. Propozim Plani i punës së KKSBB, për vitin 2022- Kalendari i aktiviteteve të rregullta
12. Matja e performancës së Komunës për vitin 2020
13. Ndryshimi i përbërjes së Komisionit Komunal të aksionarëve të ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë (*pas ofrimit të dorëheqjes nga njëri prej anëtarëve të Komisionit nga radhët e Kuvendit të Komunës*)
14. Të ndryshme

Mbledhja e mbajtur më 31.10.2022 e vazhduar më 03.11.2022 dhe rivazhduar më 07.11.2022- rregullt

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:
30 qershor 2022; 29 korrik 2022; 12 shtator 2022 dhe 29 shtator 2022
2. Informatë nga Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë *(nuk është diskutuar kjo pikë e rendit të ditës për shkak të ndërprerjes së mbledhjes)*
3. Propozim Rregullorja për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale
4. Raporti Financiar i Komunës për periudhën janar – shtator 2022
5. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve në Qytetin e Podujevës
6. Propozim vendimet për:
 - *Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: “Ushton Lumi” në Popovë-Komuna e Podujevës, si Peizazh i Mbrojtur (arsyeshmëria profesionale e MMPHI – AMMK / IKMN)*
 - *Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: “Trungu i Qarrit” (Quercus cerris) në Fshatin Lupç i Poshtëm-Komuna e Podujevës, si Monument i Natyrës (Elaborat i arsyeshmërisë profesionale-MMPHI - AMMK / IKMN)*
7. Propozim vendimi për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës
8. Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023
9. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa *(pas dhënies së dorëheqjes të anëtarës së Komitetit)*
10. Kërkesa e Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimeve që ndërliken me bashkëpunimin komunal ndërkombëtar me qytetin EMES te shtetit IOWA ne SHBA *(pikë shtesë e rekomanduar nga KPF)*
11. Ndryshim plotësimi i Komitetit për Komunitete *(pikë shtesë e rekomanduar nga KPF)*
12. Të ndryshme

Mbledhja e mbajtur më 09.12.2022 - rregullt

1. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës
2. Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës
3. Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023
4. Rishqyrtimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoha komunale *(pikë shtesë e rekomanduar nga KPF)*
5. Rishqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane *(pikë shtesë e rekomanduar nga KPF)*
6. Të Ndryshme

Nga mbledhjet e mbajtura në vitin 2022, aktet e miratuara, janë:

Vendimet:

NR	EMËRTIMI	NR. PROTOKOLLIT	DATA E MIRATIMIT
1	Vendim për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore 2023-2024	01-400/03-0003128/22	14.01.2022
2	Vendim për ngritjen e Grupit Punues për përgatitjen e draft planit të punës së Kuvendit të Komunës për 2022	01-020/04-0003135/22	14.01.2022
3	Vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022	01-463/02-0014587/22	28.02.2022
4	Vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a	01-020/04-0014598/22	28.02.2022
5	Vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë	01-020/04-0014604/22	28.02.2022
6	Vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë	01-020/04-0014612/22	28.02.2022
7	Vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete. <i>(vlerësim i MPL, jo në harmoni me U.A. 05/2020)</i>	01-020/04-0014613/22	28.02.2022
8	Vendim për vënien në diskutim - Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve	01-070/05-0014619/22	28.02.2022
9	Vendim për vënien në diskutim - Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të komunës së Podujevës	01-070/05-0014622/22	28.02.2022
10	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - çerdhe publike në qytetin e Podujevës	01-353/01-0014629/22	28.02.2022
11	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - çerdhe publike në fshatin Batllavë	01-353/01-0014634/22	28.02.2022
12	Vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës – Për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.	01-020/04-0014637/22	28.02.2022
13	Vendim për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. <i>(vlerësim i MBPZHR, jo në harmoni me ligjin për pyje)</i>	01-550/01-0014605/22	28.02.2022
14	Vendim për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës	01-016/01-0014601/22	28.02.2022
15	Vendim - ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në kuvendin e komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018, dhe atë; Ndërrimi i qëllimit të përdorimit të objekti, "pushimorja për nxënës dhe fëmijë" në fshatin Orllan – <i>(vlerësim i MMPHI, jo në harmoni me legjislacionin në fuqi)</i>	01-354/02-0014599/22	28.02.2022

16	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a	01-400/03-014595/22	28.02.2022
17	Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022	01-401/05-0014592/22	28.02.2022
18	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare - Ndahen mjete financiare në shumë 70,000.00 €, ndihmë qytetarëve në nevojë, me pako ushqimore-higjienike, në Komunën e Podujevës, për shkak të situatës së krijuar nga rritja e vazhdueshme e çmimeve të produkteve bazike.	01-400/03-0019635/22	16.03.2022
19	Vendim për ngritjen e komisionit ad-hoc- Për mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes të pakove ushqimore dhe higjienike, ndihmë familjeve në nevojë, sipas vendimit nr.prot.01-400/03-0019635/22 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 16.03.2022	01-020/04-0019638/22	16.03.2022
20	Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës (HZK) për periudhën 2022-2030	01-020/02-0030654/22	29.04.2022
21	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2021 në vitin 2022 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore	01-400/01-0030659/22	29.04.2022
22	Vendim për nisjen e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - NPL	01-016/01-0030688/22	29.04.2022
23	Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	01-016/01-0030693/22	29.04.2022
24	Vendim për vënien në diskutim - Propozim Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Hakif Zejnullahu" në Podujevë	01-016/01-0030702/22	29.04.2022
25	Vendim për vënien në diskutim - Propozim Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale	01-016/01-0030712/22	29.04.2022
26	Vendim - Pezullohet përkohësisht zbatimi i dispozitave: neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2, të rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020.	01-016/01-0030723/22	29.04.2022
27	Vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete. <i>Procedurë e rishqyrtimit</i>	01-020/02-0030731/22	29.04.2022
28	Vendim - Anullohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, i miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022. <i>Procedurë e rishqyrtimit</i>	01-016/01-0030738/22	29.04.2022
29	Vendim - Anullohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-354/02-0014599/22 i datës 28 shkurt 2022 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar nga kuvendi i komunës më 02.11.2018 <i>Procedurë e rishqyrtimit</i>	01-354/02-0030741/22	29.04.2022

30	Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023/2025 e Komunës së Podujevës	01-400/01-0053045/22	30.06.2022
31	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - çerdhe publike në hapësirën e SHFMU "Xheladin Rekalju" në Podujevë	01-353/01-0053352/22	30.06.2022
32	Vendim për vënien në diskutim publik: 1.Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës, 2.Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës: Trungu i Qarrit (quercus cerris) në fshatin Lupç i Poshtëm të Podujevës si monument i natyrës,	01-016/01-0053355/22	30.06.2022
33	Vendim për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e draft rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.	01-020/04-0053358/22	30.06.2022
34	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysmë - olimpikë në Podujevë.	01-353/01-0053357/22	30.06.2022
35	Vendim për ndryshimin e emërimit të dy shkollave të mesme profesionale SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLT "Isa Boletini" nga shkolla të mesme të larta profesionale, në Institucione të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional	01-610/01-0053360/22	30.06.2022
36	Vendim për shpalljen e z.Halil Kastrati "qytetar nderi" i Komunës së Podujevës.	01-016/01-0053362/22	30.06.2022
37	Vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Zhvillim Ekonomik	01-020/04-0053367/22	30.06.2022
38	Vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Barazi Gjinore	01-020/04-0053366/22	30.06.2022
39	Vendim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	01-020/04-0053370/22	30.06.2022
40	Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023	01-414/04-0062838/22	29.07.2022
41	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete, sipas vendimit të datës 29.04.2022	01-020/04-0062844/22	29.07.2022
42	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizimi dhe montimi i serrave"	01-400/03-0062848/22	29.07.2022
43	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizimi me mekanizëm bujqësor"	01-400/03-0062850/22	29.07.2022
44	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizimi me mëshqerra"	01-400/03-0062852/22	29.07.2022
45	Vendim për miratimin e projektbuxhetit të komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2024-2025	01-400/03-0084071/22	29.09.2022
46	Vendim për rialokimin e investimeve kapitale të komunës për vitin 2022	01-400/03-0084078/22	29.09.2022
47	Vendim për vënien në diskutim publik - Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal-SZHLE 2023/2025 e Komunës së Podujevës	01-300/01-0084085/22	29.09.2022
48	Vendim për vënien në diskutim publik - Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban- Komuna e Podujevës	01-350/05-0084092/22	29.09.2022

49	Vendim për vënien në diskutim publik - Propozim Rregullorja për Bonuset e Zonimit	01-350/04-0084093/22	29.09.2022
50	Vendim për vënien në diskutim publik - Propozim Rregullorja për transportin e udhëtarëve me automjete taksi	01-340/01-0084089/22	29.09.2022
51	Vendim për vënien në diskutim publik - Propozim Rregullorja për transportin rrugor në territorin e komunës së Podujevës	01-340/01-0084084/22	29.09.2022
52	Vendim për vënien në diskutim publik - Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit	01-340/01-0084079/22	29.09.2022
53	Vendim për miratimin e Planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022	01-016/01-0084069/22	29.09.2022
54	Vendim - Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot.01-020/04-0014604/22 i datës 28 shkurt 2022 për ngritjen e Komisionit Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike- Stacioni i Autobusëve Podujevë, përkatësisht përbërja e anëtarëve të Komisionit.	01-020/04-0084065/22	29.09.2022
55	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve - Podujevë	01-353/01-0093831/22	03.11.2022 Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
56	Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës "Ushton Lumi" në Popovë - Komuna e Podujevës, si Peizazh i Mbrojtur	01-633/01-0093834/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
57	Vendim Për mbrojtjen e Vlerës së Natyrës "Trungu i Qarrit" (Quercus cerris) në Fshatin Lupç i Poshtëm – Komuna e Podujevës, si Monument i Natyrës	01-633/01-0093840/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
58	Vendim për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës. (vlerësim nga MAPL, jo në harmoni me legjislacionin në fuqi)	01-020/04-0093836/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
59	Vendim për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e draft planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023	01-020/04-0093833/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
60	Vendim - Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30.12.2021	01-020/04-0093828/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
61	Vendim - Miratohet kërkesa e Kryetarit të Komunës e datës 28 tetor 2022, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimeve që ndërlidhen me nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me Qytetin AMES në Shtetin IOWA të SHBA	01-016/01-0093821/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
62	Vendim - Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Komunitete, sipas Vendimit nr.prot.01-020/02-0030731/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të datës 29 prill 2022, me ndryshim plotësimin sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0062844/22 të datës 29 korrik 2022	01-020/04-0093813/22	07.11.2022 Ri-Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022
63	Vendim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025	01-060/01-0101079/22	09.12.2022

64	Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës	01-400/03-0101080/22	09.12.2022
65	Vendim për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023	01-462/01-0101082/22	09.12.2022
66	Vendim - anulohet Rregullorja nr.prot.01-431/03-0093814/22 për taksa tarifa dhe gjoba komunale, e miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 03 nëntor 2022 <i>Procedurë e Rishqyrtimit</i>	01-431/03-0101083/22	09.12.2022
67	Vendim- formimi i komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e komunës së Podujevës – <i>Procedurë e Rishqyrtimit</i>	01-020/04-0101084/22	09.12.2022

Nga numri i vendimeve të paraqitura, janë publikuar 56 prej tyre.

4 Vendime nuk janë publikuar për shkak të vlerësimit të tyre jo në harmoni me legjislacionin në fuqi, e që të njëjtat janë rishqyrtuar në mbledhjet përkatëse të radhës.

7 Vendime (4 prej tyre nga mbledhja e dt.09.12.2022) nuk janë publikuar për shkak të mos kthimit ende të përgjigjeve nga Ministrinë përkatëse në procedurën e shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi, e që në bazë të konsultave dhe bisedave me zyrtar të Ministrive na është rekomanduar që të mos publikohen aktet pa pasë konfirmim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Rregulloret:

NR	EMËRTIMI	NR. PROTOKOLLIT	DATA E MIRATIMIT
1	Rregullore për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve	01-016/01-0030667/22	29.04.2022
2	Rregullore për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës	01-610/01-0030684/22	29.04.2022
3	Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës	01-016/01-0058139/22	15.07.2022
4	Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës	01-462/01-0062841/22	29.07.2022
5	Rregullore për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës	01-300/01-0084080/22	29.09.2022
6	Rregullore për taksa tarifa dhe gjoba komunale <i>(vlerësim i disa Ministrive, jo në harmoni me disa Ligje dhe akte tjera në fuqi)</i>	01-431/03-0093814/22	03.11.2022 <i>Vazhdim i mbledhjes së 31.10.2022</i>

Nga këto Rregullore, 5 prej tyre janë publikuar, kurse 1 nuk është publikuar për shkak të vlerësimit jo në harmoni me legjislacionin në fuqi

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA – KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2022 ka mbajtur 9 mbledhje, prej tyre 7 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.

Komiteti për Politikë dhe Financa që nga themelimi dhe konstituimi ka shqyrtuar të gjitha çështjet e propozuara për shqyrtim në Kuvendin e Komunës dhe për të njëjtat i ka rekomanduar Kuvendit sugjerime, propozime dhe ndryshime përkatëse, duke përfshirë pika shtesë apo edhe heqje të ndonjë pike/teme të planifikuar për shqyrtim në Kuvend varësisht nevojave dhe kërkesave të paraqitura.

Në vijim paraqiten konstatimet e rekomanduara nga mbledhjet e KPF-së:

Më 13.01.2022 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 14 janar 2022.

Pas miratimit të rendit të ditës, diskutimeve dhe sqarimeve nga anëtarët e Komitetit dhe anëtarit të Ekzekutivit për pikat përkatëse të rendit të ditës konstatohet se Kuvendit të Komunës i rekomandohet, si në vijim;

- **Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024**

Me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimit për projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

- **Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022**

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit për ngritjen e Grupit Punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, me strukturën e mbështetur nga anëtarët e Komitetit, dhe atë:

Grupi punues të përbëhet prej 7 anëtarëve, prej tyre 5 anëtar nga radhët e Kuvendit (nga 1 prej secilit subjekt politikë të përfaqësuar në Kuvend) dhe 2 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.

Më 25.02.2022 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e caktuar të mbahet më 28 shkurt 2022

Fillimisht:

-Në kërkesë dhe propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Njësëri u përkrahë që në kuadër të rendit të propozuar të ditës të përfshihet edhe pika shtesë:

- **Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinae - KRM “Pastrimi” Sh.A.** (dhe atë sipas renditjes së rendit të ditës)

-Në kërkesë dhe propozim të anëtarit të KPF-së z.Bashkim Syla, me 6 vota për, dhe 3 vota kundër, u përkrahë propozimi që në kuadër të rendit të propozuar të ditës të përfshihet edhe pika shtesë;

- **Propozim vendim për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, propozim vendim i njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re.** (dhe atë sipas renditjes së rendit të ditës)

(Në kërkesë të z.Naim Çunakut, theksohet se vota kundër nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LDK-së është për arsye të formës se si u propozua për pezullim të dispozitave të cekura të Rregullores në fjalë, mirëpo si Grup kërkojmë që Rregullorja në fjalë të sjellët si pikë e veçantë për plotësim-ndryshim të tërësishëm në një rën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit)

- Po ashtu në kërkesë dhe propozim të anëtares së KPF-së znj.Adelinë Stublla, me 6 vota për, dhe 3 vota kundër, u përkrahë propozimi që në kuadër të rendit të propozuar të ditës të përfshihet edhe pika shtesë;

- **Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022.** (dhe atë sipas renditjes së rendit të ditës)

Pas miratimit të rendit të ditës, përfshirë edhe pikat shtesë, diskutimeve dhe sqarimeve të anëtarëve të Komitetit dhe anëtarëve të Ekzekutivit për pikat përkatëse të rendit të ditës, konstatimet e rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës të caktuar për datë 28 shkurt 2022, janë si në vijim:

➤ **Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022.**

Nga 8 anëtarë që ishin prezent në procesin e votimit, me 5 vota për dhe 3 vota kundër, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

➤ **Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinae “Pastrimi” sh.a.**

Njësëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me theks që emrat e anëtarëve të komisionit të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

➤ **Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë.**

Njësëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me theks që emrat e anëtarëve të komisionit të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

➤ **Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë.**

Njësëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me theks që emrat e anëtarëve të komisionit të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

➤ **Propozim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.**

